

---

**JETA SHKENCORE**

---

**SESION SHKENCOR NË PRISHTINË  
KUSHTUAR AKADEMIK ALI HADRI**

Më 3 mars 2008 Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Instituti i Historisë-Prishtinë dhe Departamenti i Historisë pranë Universitetit të Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin e Historisë - Tiranë, organizuan Simpoziumin shkencor: “Jeta dhe vepra e Akademik Ali Hadrit”.

Veprimtaria, e cila ngjalli mjaft interes dhe u karakterizua nga prania masive e dëgjuesve dhe medias, u përshëndet nga Presidenti i Republikës së Kosovës z. *Fatmir Sejdiu*, që e vlerësoi Akademik Ali Hadrin si intelektual, studiues e njeri të rrallë.

Fjalën e hapjes së punimeve të simpoziumit e mbajti Akademik *Rexhep Ismajli*, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në emër të familjes Hadri simpoziumin e përshëndetën fëmijët e Ali Hadrit, *Lumi Hadri* dhe *Arbër Hadri*.

Prof. dr. *Agim Hyseni* përshëndeti veprimtarinë në cilësinë e zv. Ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Kurse në emër të Institutit të Historisë – Tiranë një fjalë përshëndetëse e vlerësuese për veprën e Akademik Ali Hadrit mbajti Prof. dr. *Marenglen Verli*.

Në vijim të simpoziumit u lexuan tre referate. Drejtori i Institutit të Historisë – Prishtinë, Prof. Dr. *Jusuf Bajraktari* referoi temën “Akademik Ali Hadri shkencëtar dhe patriot i shquar”. Pas tij Akademik *Kristaq Prifti*, (Tiranë) mbajti referatin “Akademik Ali Hadri, përballë historiografisë jugosllave në redaksinë e Enciklopedisë së Jugosllavisë në vitin 1980”. Kurse Prof. dr. *Zekeria Cana* lexoi referatin “Ali Hadri përballë procesit të diferencimit ideo-politik të intelektualëve shqiptarë”.

Në seancat që pasuan u mbajtën këto kumtesa: Prof. dr. *Edi Shukriu*: “Kontributi i Akademik Ali Hadrit në trajtimin e historisë së lashtë”. Mr. *Arbën Arifi* “Shkrimet e Ali Hadrit për ilirët”, Mr. Bedri Muhadri: “Vështrim mbi studimin e Ali Hadrit për epokën e Skënderbeut”, Prof. dr. *Emine Bakalli*: “Akademik Ali Hadri për studimet e periudhës midis Dy Luftërave Botërore”, Prof. dr. *Fehmi*

*Rexhepi*: “Lufta e Dytë Botërore në opusin e Ali Hadrit”, Prof. dr. *Muharrem Dezhgiu* (Tiranë): “Probleme historiografike për Luftën e Dytë Botërore të Shqipërisë në veprën e Ali Hadrit”, Mr. *Frashër Dema*:, “Kontributi i Profesor Ali Hadrit në fushën e arsimit”, Prof. dr. *Drita Cunga* dhe Prof. dr. *Sulltane Ukaj*: “Kontributi i Ali Hadrit në botimin e revistave shkencore “Përparimi”, “Gjurmime Albanologjike” dhe “Kosova”, Prof. dr. *Xhelal Gjeçovi* (Tiranë): “Polemika e Ali Hadrit me Svetozar Vukmanoviç- Tempon rreth themelimit të PKS-së”, Mr. *Qemal Morina*: “Polemika e Akademik Ali Hadrit me Njazi Limanovskin rreth përhapjes së islamit në Maqedoni”, Prof. dr. *Fazli Syla*: “Kontributi i Ali Hadrit në politikën arsimore dhe shkencore të Kosovës”, Prof. dr. *Isa Bicaj*: “Kontributi i Ali Hadrit për ngritjen e kuadrove shkencore”, Prof. dr. *Ymer Jaka*: “Trashëgimia publicistike e Ali Hadrit pas vitit 1981”, Prof. dr. *Fatmira Musaj* (Tiranë): “Angazhimi i Ali Hadrit për emancipimin e femrës shqiptare”, Prof.dr. *Sabile Keçmezi-Basha*: “Akademik Ali Hadri në mbrojtje të simboleve kombëtare”, Mr. *Mehmet Gjoshaj*: “Kontributi i Akademik Ali Hadrit në ndriçimin e Reformës Agrare dhe kolonizimit në Kosovë”, Prof. dr. *Izber Hoti*: “Trajtimi i çështjeve historike në veprimtarinë e Ali Hadrit”, Prof. dr. *Haki Kasumi*: “Ndihmesa e Ali Hadrit në trajtimin e çështjeve të fesë” dhe *Munish Hyseni*: “Bibliografia e Ali Hadrit”.

Fjalën e mbylljes së punimeve të simpoziumit e mbajti Prof. dr. *Jusuf Bajraktari*, i cili nënvizoi ndër të tjera se veprimtaria ishte një homazh për mësuesin, shkencëtarin dhe kolegun e nderuar me rastin e 80-vjetorit të lindjes dhe, njëherësh, 20-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta. Me këtë rast ai falënderoi studiuesit e Institutit të Historisë-Tiranë që kontribuan me kumtesat e tyre në punimet e simpoziumit shkencor.

Materialet e Simpoziumit, të përmbledhura në një vëllim, i cili shoqërohet edhe me një album fotografish të Akademik Ali Hadrit, u përgatitën për botim dhe dolën nga shtypi në fillim të vitit 2009.

**Marenglen VERLI**